SH.M.K. Gjimnazi ’’Kiril Pejcinoviq’’ Tetovë

Program për realizimin e shëtitjes njëditore në SH.M.K. Gjimnazi |”Kiril Pejçinoviq”-Tetovë

Viti shkollor 2024/ 2025

Gusht 2024

Programi për realizimin e shëtitjes njëditore në SH.M.K. Gjimnazi "Kiril Pejcinoviq" – Tetovë Viti shkollor 2024/ 2025

Ekskursionet dhe shëtitjet jane formë e punës edukativo - arsimore të cilat zhvillohen nëpërmes aktivitete të ndryshme jashtë ambienteve të shkollës duke vizituar: vende turistike, vendbanime kulturore, edukative dhe sportive dhe lokalitete tjera. Të gjitha këto në përputhshmëri me detyrat dhe qëllimet e programeve mësimore që kanë për qëllim zhvillimin dhe plotësimin e interesave të ndryshme të nxënësve.

Shkolla jonë edhe këtë vit organizon shëtitje njëditore – nga një në të dy gjysmëvjetorët, edhe atë në paralelet me mësim në gjuhën shqipe dhe atë maqedone. Shëtitja e pare njëditore realizohet në muajin Tetor ose Nëntor, ndërsa ajo e dyta gjatë muajit Prill (varësisht nga kushtet klimatike). Shëtitjet njëditore kanë të bëjnë me tema dhe përmbajtje të lidhura me programën mësimore, shëtitje njëditore në lidhje me vizita të muzeve , bukurive natyrore, busteve, shtëpi muze, dhe qëllime sociale. Këto shëtitje do të realizohen në dy relacione të ndryshme sipas zgjedhjes së nxënësve.

Qëllimet edukativo-arsimore- nxënësit ti zgjerojnë njohuritë e tyre, të zhvillojnë interesat e tyre , të formojnë bindje nëpërmes njohjes së drejtëpërdrejtë të dukurive si dhe të zhvillojnë marrëdhënje pozitive ndaj bashkëmoshatarëve të tyre.

Detyrat: zhvillimi i një qëndrimi pozitiv ndaj vlerave kulturore, artistike, shkencore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zhvillimi i interesit dhe kujdesit për natyrën dhe praktikimi i shprehive ekologjike, njohja e mënyrës së jetesës së njerëzve në pjesë të ndryshme të vendit tonë, formimi i një qëndrimi pozitiv ndaj vlerave kulturore dhe estetike; nxitja e emocioneve pozitive, miqësisë dhe njohjes me njëri-tjetrin, socializimi, përvojat, krijimi i një kulture për një jetë të shëndetshme.

Përmbajtja dhe aktivitetet: relacioni që do të zgjedhet, gjegjësisht vendbanimi, planifikohet një vizitë në atë vend, vizita në pika të caktuara, muze, monumente, shtëpi përkujtimore, pastaj do të kryhen aktivitete për shoqërim dhe rekreacion të nxënësve jashtë në mënyrë që të njihen dhe të komunikojnë më mirë.

Udhëheqës të ekskursionit: Prof. Nazif Shabani - për nxënësit e viteve të II-ta dhe viteve të IV-ta, si dhe Prof. Imer Islami për nxënësit e viteve të I-ra dhe viteve të III-ta.

Arsimtarët : kujdestarë të klasave dhe arsimtarë të viteve: I, II, III dhe IV-ta.

Kohëzgjatja: Një ditore.

Vendet për t'u vizituar dhe destinacionet e udhëtimit - nxënësit do të realizojnë ekskursion (shëtitje njëditore) brenda ose jashtë vendit, me program të përgatitur që më parë, me

pëlqim paraprak të marrë nga këshilli i prindërve dhe këshilli i arsimtareve lidhur me atë se si dhe kur do të realizohet ai.

Organizimi teknik: Ekskursionet do të realizohen në bazë të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore për nxënësit e shkollave të mesme dhe do të realizohen nga shkolla dhe agjencia turistike **që do të përzgjidhet përmes shpalljes publike.**

Mënyra e financimit: me vetfinancim të nxënësve, të cilët në nivel klase do të kryejnë një pagesë në xhiro llogarinë e agjencisë që është zgjedhur me thirrje publike. Çmimi për një ekskursion njëditor do të ofrohet nga agjencia.

Drejtor

Gusht 2024 Jeton Kamberi

SH.M.K. GJIMNAZI ’’KIRIL PEJCINOVIQ’’ TETOVË

PROGRAM PËR REALIZIMIN E EKSKURSIONIT PËRFUNDIMTAR NË SH.M.K. "KIRIL PEJCINOVIQ"-TETOVË PËR VITIN SHKOLLOR 2024/25

Gusht 2024

Program për realizimin e ekskursionit përfundimtar në SH.M.K. "Kiril Pejcinoviq"-Tetovë për vitin shkollor 2024/25

Eskursioni është një udhëtim i organizuar nga një grup i njerëzve, i cili zakonisht bëhet në kohën e lirë, me qëllim arsimi apo për aktivitet fizik, vizitë të një vendi, nganjëherë për punë dhe qëllime të tjera. Por, kur kemi të bëjmë me ekskursionet shkollore nënkuptohet se kemi të bëjmë me eskursionet mësimore.

Objektiv i eskursionit mësimor, patjetër duhet të jetë arritja e njohurive të cilat duhen të arrihen, por që nuk mund të demonstrohet në objektet shkollore.

Eskursionet shkollore janë një formë e punës edukative që realizohet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme jashtë shkollës nëpërmjet shëtitjeve, eskursioneve dhe vizitave në: vende turistike, institucione arsimore, kulturore e sportive dhe lokalitete të tjera, në përputhje me qëllimet dhe detyrat e kurrikulave për zhvillimin dhe realizimin e interesave tëndryshme të nxënësve.

Shkolla jonë SHMK "Kiril Pejçinoviq" edhe këtë vit shkollor planifikon dhe organizon një eskursion përfundimtar disaditor për nxënësit e vitit III-të me mësim në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Eskursioni përfundimtar disaditor për nxënësit nga viti i III-të, është planifikuar gjatë muajit prill. Eskursioni final për nxënësit e paraleleve me mësim në gjuhën shqipe është planifikuar që të realizohet në muajin prill me relacion: Tetovë - Elbasan - Durrës - Krujë - Shkodër - Lezhë - Berat - Tiranë - Prekaz -Tetovë.

Eskursione përfundimtare disaditore planifikohen dhe parashihen që nxënësit të përfshihenë në aktivitete për njohjen e pasurive dhe vlerave natyrore, kulturore, historike, arkeologjike dhe estetike të vendeve të tjera.

Qëllimet arsimore:

Nxënësit të zgjerojnë njohuritë dhe të zhvillojnë interesa të ndryshme, të formojnë qëndrime nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë me dukuri të ndryshme, të zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj shokëve dhe bashkëmoshatarëve;

Detyrat:

Zhvillimi i një qëndrimi pozitiv ndaj vlerave kulturore, artistike, shkencore në vendet e tjera, njohja me kultura dhe monumente të ndryshme në vende të tjera, njohja me kulturën dhe mënyra

e jetesës së njerëzve në vendet e tjera, formimi i një qëndrimi pozitiv drejt vlerave kulturore dhe estetike, nxitjes së emocioneve pozitive, miqësisë dhe njohjes me njëri-tjetrin, shoqërimit, përvojave.

Përmbajtja dhe aktivitetet:

Itinerari i paraparë për eskursionin përfundimtar të nxënësve të viteve të III-ta është :

Tetovë – Elbasan – Durrës – Krujë – Shkodër – Lezhë – Berat -Tiranë - Prekaz – Tetovë.

Shëtitje nëpër qytete, vizitë objekteve me vlera të caktuara muze, monumente kulturore, historike dhe arkeologjike, poashtu planifikohen aktivitete gazmore për shoqërim dhe rekreacion të nxënësve me qëllim njohjen dhe komunikimin më të mirë me njëri-tjetrin.

Udhëheqës ekskursioni: Prof. Imer Islami

Mësimdhënësit: kujdestarët e klasavetë të vitit të tretë – (III-1,2,3....,12).

Kohëzgjatja: 5 ditë e 4 netë.

Vendet për vizitë dhe rrugët e udhëtimit: Gjatë eskursionit përfundimtarë për nxënësit e vitit të III, është paraparë vizitë në qytetet si : Elbasan, Durrës, Krujë, Shkodër, Lezhë, Berat, Tiranë, Prekaz.

Organizimi teknik: Eskursioni është planifikuar të realizohet në bazë të Rregullores për mënyrën e organizimit të ekskursioneve shkollore për nxënësit e shkollave të mesme dhe i njejti do të realizohet nga shkolla dhe agjencia turistike që do të përzgjidhet në shpallje publike.

Do të zgjidhet agjencioni që është më i favorshmi për nxënësit dhe që plotëson të gjitha kriteret për organizimin e eskursioneve të këtilla.

Mënyra e financimit: nxënësit, pra secili nxënës do të kryejë një pagesë të veçantë në xhiro llogarinë e agjencisë që u zgjodh si më e favorshme në shpalljen publike. Çmimi për eskursionin përfundimtar për nxënësit e viteve të treta do të ofrohet nga agjencia, e cila do të zgjidhet si më e favorshme për nxënësit.

Gusht 2024

Drejtor
Jeton Kamberi